

	Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo	
	Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
	Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing	
02	No.Nr.	252-20
	Tarih/Dt.	19.11.2020



**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës  
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**

**Referencia : 626/20/032/136**

Në bazë të paragrafit 6 të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe në bazë të Rregullave për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave të rregullores së Prokurimit Publik neni 4 pikë b dhe nenin 8 parografi 8.1 pikë 8.1.1 bie këtë :

## **V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për Rishqyrtim e Operatorit Ekonomik - “AWA”SH.P.K- PRISHTINË e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 18.11.2020 për aktivitetin e prokurimit me nr. 626-20-6717-1-3-6 dhe nr. të brendshëm: 626-20-032-1-3-6 me titull “Furnizimi me pajisje mbrojtëse dhe materiale të ndryshme dezinfektuese kundër Covid 19”

||

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.*

## **A R S Y E T I M**

Operatori ekonomik “AWA” SH.P.K nga Prishtina më datën 18.11.2020 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njostimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues, në të cilin njoftim është përcaktuar përfituesi i tenderit për “Furnizimi me pajisje mbrojtëse dhe materiale të ndryshme dezinfektuese kundër Covid 19” për Komunën e Mamushës.

Si autoritet kontraktues, pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar e kemi shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim, duke u bazuar ne nenin 8 paragrafi 8.1 pika 8.1.1 te regullores për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim, pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave. "AWA" SH.P.K nga Prishtina, ka paraqitur pretendime se janë shkelur dispozitat e neneve 1, 6, 7, 52.3, 56.3, 59, 60 dhe neni 41 i RRUOP duke paraqitur fakte **të pa bazuara** si më poshtë.

O.E. në pretendimin e parë ka cekur se Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar tenderin e tyre në bazë të kritereve të cilat nuk janë paraparë në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë gjë e cila nuk është e vërtetë, pasi që ne e kemi bërë vlerësimin në përshtatje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimin për kontratë dhe nuk kemi cekur se O.E. ankues nuk e ka plotësuar ndonjë kriter. Në dosje të tenderit janë kërkuar specifikat teknike të cilat duhet ti plotësojnë artikujt e kërkuar nga ana jonë. Duke u bazuar në nenin 59 paragrafi 2 ne si Autoritet Kontraktues për të siguruar se materialet të cilat i kanë ofruar Operatorët Ekonomik i plotësojnë specifikat teknike sipas aneksit 1 të dosjes së tenderit, me datë 10.11.2020 kemi kërkuar sqarim nga të gjithë tenderuesit në lidhje me tenderët e tyre si dhe kemi kërkuar që të sillen mostrat për artikujt 1, 2, 5, 6, dhe 7 pasi që janë ofruar çmime të cilat janë jo normalisht të ulëta në krahasim me çmimet e tregut.

Fakti se kërkesën për sqarim të tenderit, ia kemi dorëzuar përmes sistemit të e-prokuirimit të gjithë O.E. pjesëmarrës, nënkupton se të gjithë O.E. janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese. Në nenin 39 paragrafi 39.6 shprehimisht është paraparë që AK do të caktoj afat kohorë të arsyeshëm për O.E. për sqarim të tenderit të tyre. Duke pasur parasysh gjendjen e rëndë të pandemisë me qëllim të furnizimit me pajisje mbrojtëse dhe dezinfektues, ne në kërkesën tonë të datës 10.11.2020 kemi kërkuar nga të gjithë O.E. pjesëmarrës që ti sjellin mostrat me datë 10.11.2020 deri në ora 15:00 që nënkupton se kemi dhënë një afat të arsyeshëm për sjellje të mostrave. Gjithashtu i kemi paralajmëruar të gjithë O.E. mos dorëzimi eventual nga ana e juaj i mostrave të kërkuar, brenda afatit kohor të lartë shënuar, do të qoj në eliminimin tuaj dhe tenderi i juaj do të refuzohet.

Edhe pretendimi se është shkelur afati ligjor është i pa bazë, pasi që në kërkesën për sqarim përmes letrës standarde, është caktuar afati kohor brenda të cilit duhet të jepet sqarimi nga ana e Operatorëve Ekonomik dhe afati i fundit ka qenë me datë 10.11.2020 ora 15:00 e jo 15.11.2020 sikur pretendon O.E. ankues në kërkesën për rishqyrtim të vendimit për dhënie të kontratës.

Në nenin 39 paragrafi 39.7 shprehimisht është paraparë që nëse O.E. dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK tenderi përkatës do të refuzohet. Andaj me qenë se O.E. ankues nuk i është përgjigjur kërkesës për sqarim të parashtruar nga ana e AK-s tenderi i është refuzuar.

Gjithashtu edhe pretendimi se O.E. ankues ka dorëzuar tenderin me çmimin më të ulët, është i pa bazuar pasi që në mesin e tenderuesve pjesëmarrës, ka pasur tenderues që ka ofruar çmimin më të ulët se O.E. ankues por që i njëjti nuk i është përgjigjur kërkesës së AK-s brenda afatit të kërkuar, andaj edhe i është refuzuar tenderi duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartcekura.

Pra duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe dëshmitë dhe faktet e paraqitura si dhe në analizimin dhe vlerësimin e çështjeve te cilat i ka theksuar Operatori Ekonomik ankues, konsiderojmë se pretendimet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim te parashtruar nga O.E asesi nuk janë të bazuara, sepse sa i përket pretendimeve qe kinse kemi shkelur ligjin dhe udhëzuesin, absolutisht provat tregojnë se Autoriteti Kontraktues ka respektuar ne përpikëri të gjithë procedurën e prokurimit duke respektuar legjislacionin në fuqi të prokurimit publik.

**Andaj,**

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me dt. 19.11.2020

Gazmend Gashi

Udhëheqësi i sektorit të prokurimit

Komuna Mamushës



Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej dhjet (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.